

***BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE
“HIVZI SULEJMANI” E PRISHTINËS***

***DREJTORISË PËR KULTURË DHE GJINI
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS***

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2004

***PRISHTINË,
DHJETOR 2004***

SEKTORI PËR ZHVILLIM DHE PËRPARIM BIBLIOTEKAR

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2004

Bibliotekat, kudo në botë, janë institucione kulturore dhe arsimore shumë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe formimin e identitetit kulturor të një populli, prandaj ato kanë përkrahje të pazezervë nga shteti. Biblioteka ndërkomunale “Hivzi Sulejmani” përpiket ta luajë këtë rol dhe është në shërbim të të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh nacionalitetin, moshën, gjininë, përkatësinë fetare etj.

Viti 2004 ishte një vit me suksese të dukshme si në veprimtarinë bibliotekare, realizimin e shërbimeve, aktiviteteve të larmishme që u zhvilluan në bibliotekë, ashtu edhe në pasurimin e fondeve me tituj të rinj. Përveç buxhetit të caktuar që ndanë çdo vit Ministria e Kulturës për bibliotekë, kishte një përkrahje të madhe nga Drejtorati për Kulturë Rini dhe Gjini i Komunës së Prishtinës për pasurimin e fondeve dhe renovimin e objekteve të degëve në fshatra.

Gjithashtu ka një rritje të dukshme të numrit të lexuesve.

Punët profesionale

Përveç punëve profesionale si: përpunimi i librit, klasifikimi, katalogimi, printimi, puna me lexues, të cilat janë kryer në mënyrë profesionale, këtë vit ka filluar revizioni i librit që ishte bërë domosdoshmëri. Revizioni ka filluar më 14 qershor në sektorin për të rritur. Për shkak të vëllimit të punës kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i punëtorëve. Është verifikur secili libër në raft dhe nëpër katalogë, njëkohësisht i është shkruar skeda topografike, janë hequr ekzemplarët e tepërt, janë çregjistruar librat e dëmtuara. Revizioni në këtë sektor ka zgjatur deri më 26 tetor 2004. Në vitin 2005 do të vazhdojë edhe nëpër sektorë të tjerë dhe nëpër degë të bibliotekës. Edhe këtë vit është shtuar numri i punëtorëve, është pranuar një punëtor në Sektorin e Pasurimit dhe Përpunimit të librit dhe dy roje në degën “Biblioteka Përkujtimore”. Janë përpunuar të gjitha librat që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti.

Janë hartuar projekte për pasurimin e fondeve të bibliotekës dhe degëve të saj, janë mbledhur dhe hartuar raportet dhe programet vjetore të punës.

Koordinimi i punës me bibliotekat komunale

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare në bibliotekat komunale në Lypjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Besianë dhe Drenas, mbikëqyrjen profesionale të të cilave, bazuar në Ligjin për biblioteka, e ka obligim biblioteka jonë, gjatë muajit shkurt janë mbajtur takime me organet qeveritare të katër komunave. Projektpropozimin të cilin e ka përgatitur Drejtori i bibliotekës Z. Sylejman Pireva, ka për bazë përmirësimin e kushteve të punës, plotësimin e kuadrit, posaçërisht me përgatitje universitare, organizimin e sektorëve dhe pavarësimin e këtyre bibliotekave në të ardhmen. Ky projektpropozim u përkrah nga përfaqësuesit e qeverive të këtyre komunave, të cilët premtuan se do ta realizojnë sapo të krijohen kushtet. Rezultatet e para pozitive të këtij projektpropozimi u realizuan në bibliotekën komunale në Fushë Kosovë, ku u bë pranimi i tre kuadrove të rinj dhe u formuan këta sektorë: Sektori për përpunimin

e librit, sektori për fëmijë dhe sektori për të rritur; të dy sektorët janë me nga një sallë të leximit me një hapësirë të mjaftueshme për lexim dhe studim. Gjithashtu një ekip profesional i bibliotekës sonë ka punuar disa javë në klasifikimin dhe radhitjen e koleksioneve sipas standardeve të IFLA-s. Edhe në Besianë është zgjeruar hapësira e bibliotekës e cila vepron në kuadër të shtëpisë së Kulturës dhe janë formuar tre sektorë të domosdoshëm që disponojnë edhe salla të leximit.

Trajnimet dhe seminaret

Trajnimet: Kërkesat për trajnime dhe këshilla profesionale në adresë të bibliotekës po shtohen vazhdimisht. Edhe këtë vit në trajnim ishin dy punëtorë: një nga biblioteka në Fushë Kosovë dhe një nga biblioteka në Komaran(Bushat). Ndërsa këshilla profesionale dhe material bibliotekar kanë kërkuar bibliotekat komunale të Prishtinës, Vushtrrisë, librarja e ASHAK dhe ajo e bibliotekës për të verbër në Prishtinë.

Seminaret: Kemi marrë pjesë në seminarin njëditor me lektorë nga Sllovenia, të cilin e organizoi Ministria e Kulturës dhe SHBK. Temat e shtjelluara ishin: pasurimi i koleksioneve, selektimi i furnizuesve, spastrimi dhe çregjistrimi i koleksioneve të bibliotekës.

Në bibliotekën ndërkomunale “Latif Berisha“ në Mitrovicë, u mbajt një tryezë me tema nga bibliotekaria ku kishte të ftuar nga biblioteka publike e Fierit. Pati tema interesante. Nga biblioteka jonë me tema u paraqitën drejtori Sylejman Pireva dhe librari i lartë, Xhemail Luta.

Në maj të këtij viti nga Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës u bë prezantimi i revistave elektronike dhe mënyra e qasjes së tyre në internet për punëtorët e bibliotekës dhe për përdoruesit. Prezantimin e bëri përfaqësuesi i BKUK së, i Qendrës amerikane dhe Bukuriye Haliti punëtoare e bibliotekës sonë dhe anëtare e këtij Konsorciumi.

Në shtator:ndjekja e Sesionit informativ për Numrin Standard Ndërkombëtar të ISBN/ISMN, mbajtur nga Dr. Hartmut Walravens, me interes për botuesit, ku bënë pjesë edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës..

Pjesëmarrja në Panairin e Librit në Tiranë ishte e një rëndësie të veçantë. Nga biblioteka jonë morën pjesë dy vetë me ç’rast u blenë dhjetëra libra për të vegjlit dhe një sasi falas nga Shpresa Vreto dhe Sokol Jakova.

Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe periodikut

Krahasuar me vitet e kaluara, viti 2004 ishte viti më i begatë sa i përket pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj. Kjo u bë e mundur nga mjetet e caktuara që ndanë Ministria e Kulturës çdo vit, nga Drejtorati për Kulturë, dhe Gjini i Komunës së Prishtinës, i cili ka dhënë një kontribut shumë të çmueshëm, si në pasurimin e fondeve ashtu edhe në mirëmbajtjen e bibliotekave në fshatra dhe institucionet dhe individët të cilët i dhuruan libra bibliotekës. Në vitin 2004 kanë hyrë në bibliotekë gjithsejt 1418 tituj me 7547 kopje të librave.

Prej tyre libra të blerë 601 tit. me 5221 kopje dhe libra të dhuruar 817 tit. me 2326 kopje.

Gjithashtu furnizimi me periodik ishte në nivel. Në bibliotekën qendrore merren 5 gazeta të përditshme të cilat janë në shërbim të lexuesve. Nga këto: „Koha ditore“, Zëri“ ditor dhe „Zëri“, Pavarësia“ dhe „Epoka e re“ na janë mundësuar falas nga botuesit ndërsa „Bota sot“ merret me pagesë. Tri prej tyre „Bota sot“, Koha ditore“ dhe „Zëri“, lidhen dhe ruhen në sektorin e periodikut. Ndërsa në degën në Pallatin e Rinisë merren „Koha ditore“, „Zëri“ dhe „Pavarësia“ pa pagesë.

Në disponim të lexuesve janë edhe revistat: „Zëri“ javor, Kosovarja“, „Fjala“, „Jeta e re“ dhe „Shkëndija“ të cilat i marrim pa pagesë.

Ndërsa ndihet mungesa e revistave për fëmijë.

Aktivitetet kulturore

Shpërblimet dhe mirënjohjet:

Edhe këtë vit u organizuan aktivitete të shumta kulturore që kanë të bëjnë me librin dhe bibliotekën.

Në fillim të vitit, sipas traditës së bibliotekës, u mbajt manifestimi i dhënies së shpërblimeve për tre lexuesit më të dalluar, punëtorin më të suksesshëm, dhe mirënjohje për dhuruesit më të njohur për vitin 2004.

Lexuesit më të dalluar:

Laura Hasani- nxënëse e sh.f.“Gjergj Fishta“

Bujar Verboci- student

Behajdin Gjurgjiali-pensionist

Librat më të lexuara:

P. Coelho: Alkimisti

Dalan Shaplo: Shtëpia e diellit

Dhuruesit e librave:

Hasan Hasani, shkrimtar

Negxhmedin Nuhiu, profesor

Punëtorja më e suksesshme: Hajrije Peshku, librare-inventariste

Me këtë rast u dhanë shpërblime dhe mirënjohje.

Në degën“ Biblioteka Përkujtimore“ u shënuar 7 marsi, Dita e Mësuesit. I ftuar ishte z. Haki Krasniqi, veteran i arsimit. U dhanë shpërblime për tri poezitë dhe tri punimet artistike më të mira. Me këtë rast u dha një program i pasur artistik me lexuesit e bibliotekës.

Më 19-24 prill u mbajt „Java e Bibliotekës në Kosovë“, e cila është bërë tradicionale, ku pati aktivitete të shumta nga fusha e bibliotekarisë, promovime librash, ekspozita etj. Në kuadër të kësaj jave biblioteka jonë mori pjesë me një aktivitet ku publikoi rezultatet e konkursit letrar.

Takimet me shkrimtarë dhe krijues

Këtë vit u mbajtën disa takime me krijues në degën „Biblioteka Përkujtimore“ dhe në degën „Përrallat“.

Në degën „Biblioteka Përkujtimore“ u organizua takimi me aktorin tonë të njohur Luan Jaha, Dr. Ali Bajgora përfaqësues i Qendrës juridike për të drejtat e fëmijëve. Në degën „Përrallat“ u mbajtën takime me shkrimtarët Jonuz Fetahaj dhe Abdullah Thaçi, aktoren

Leze Qena, kompozitorin Andin Randobrava dhe mjeken Rukie Mehmeti. Të gjitha këto takime u ndoqën me intersim nga lexuesit e vegjël dhe u përcollën nga mediat elektronike dhe të shkruara.

Orët letrare:

Karvani i shkrimtarëve mbajti një orë letrare me lexuesit e degës „Biblioteka Përkujtimore“ që u ndoq me ineresim të madh. Shkrimtarët i dhuruan bibliotekës disa kopje të botimeve të tyre të fundit.

Gjithashtu u organizua orë letrare me punimet e lexuesve të bibliotekës, ku ishin të ftuar shkrimtarët Nuhi Vinca dhe Veli Veliu, të cilët i lexuan disa punime të tyre.

Klubi i Letrarëve të Rinj të Bibliotekës

Formimi i Klubit të Letrarëve të Rinj në kuadër të bibliotekës ndërkomunale „Hivzi Sulejmani“, ishte një ngjarje e rrallë dhe tani kur është afër dyvjetori i formimit të këtij klubi, janë arritur një varg suksesesh. Me qëllim të nxitjes së krijuesve të rinj dhe shtimit të anëtarëve të KLRB edhe këtë vit u shpall konkursi për poezi për të rritur ku u parapanë edhe shpërblimet. Ky manifestim u mbajt në „Javën e Bibliotekës në Kosovë“. U mbajtën takime të rregullta me anëtarët e KLRB. Ka pasur bashkëpunim të mirë me klubet letrare të shkollave të mesme.

Botimet:

Këtë vit biblioteka botoi librin me poezi të anëtarit të KLRB Kastiot Berisha me titull „Sy vjeshtë“ që e sponsoroi „Kosovapharm“ me 70% të mjeteve, kurse pjesën tjetër biblioteka. Me 23 dhjetor 2004 doli numri i parë i revistes letrare „Oaza“, botim i bibliotekës, në të cilën u prezentuan krijuesit më të talentuar të këtij klubi.

Promovimet:

Në shkurt të këtij viti u promovua libri me poezi i autores së re Donjetë Gashi „Në syprinë të shpresës“, botim i Bibliotekës si dhe promovimi i librit të poetit të ri Vilson Culaj „Daho&Ve“ që të dy anëtarë të KLRB. Me 23 dhjetor 2004 në degën në Pallatin e Rinisë është promovuar numri i parë i revistës letrare „Oaza“ e cila doli nga botimi po atë ditë.

Ekspozitat:

Në kuadër të Muajit ndërkombëtar të librit, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës u hap ekspozita me titull „Ekspozita e titujve të rinj më 2004“, të cilën e organizoi biblioteka ndërkomunale „Hivzi Sulejmani“ që kishte për qëllim prezantimin e të gjithë titujve të librave që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti. Gjithsejt u prezentuan 642 tituj të rinj.

Herë pas herë në lokalet e degëve „Biblioteka Përkujtimore“ dhe „Përrallat“ u ekspozuan punimet e lexuesve.

Dhuratë bibliotekave të tjera:

Këtë vit biblioteka jonë ka dhuruar libra këtyre bibliotekave:

1. Bibliotekës në Bardh të Madh - 355 kopje
2. Bibliotekës në Peshkopi - 51 kopje
3. Bibliotekës së shk. Mesme teknike në Vushtrri - 68 kopje
4. Bibliotekës së Fakultetit Filologjik – 51

Renovimet dhe pajisja me inventar

Edhe këtë vit ka pasur përtëritje të inventarit dhe renovime.

Në Bibliotekën në qendër, është instaluar interneti në lokal ngjitur me Sallën e leximit, i cili është në përdorim të lexuesve, gjithashtu janë blerë kompjuterë dhe printerë si dhe material të ndryshëm bibliotekar.

Në degën në Pallatin e Rinisë u lirua e gjithë hapësira e Sallës së leximit që ishte marrë nga IPKO. Janë shtuar tavolina, ulëse dhe raftë të reja.

**Prishtinë,
6 dhjetor 2004**

**Drejtori
Sylejman Pireva**